

Statistikat e kulturës

Tremujori II – 2019

Tiranë, më 5 Gusht 2019: Numri i shfaqjeve kulturore gjithsej në tremujorin e dytë 2019 është 372, duke pësuar një rritje prej 28,3 %, në krahasim me tremujorin e dytë 2018. Në institucionet qendrore të artit dhe kulturës, në tremujorin e dytë të vitit 2019, janë organizuar 18 premiera, pa pësuar ndryshim nga tremujori i dytë 2018.

Në tremujorin e dytë 2019, numri i spektatorëve është 71.970, duke pësuar rritje me 46,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Pjesëmarrja mesatare në tremujorin e dytë 2019 është 193 spektatorë për shfaqje nga 169 spektatorë të rezultuar në tremujorin e dytë 2018.

Institucione qendrore të artit dhe kulturës

Në tremujorin e dytë 2019, Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve gjithsej, me 143 të tilla, 24 shfaqje më shumë, krahasuar me tremujorin e dytë 2018. Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor ka realizuar numrin më të lartë të premierave, 12 premiera, dy më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.1 Numri gjithsej i shfaqjeve/premierave në institucionet kulturore

Numri i shfaqjeve/premiera	Shfaqje		Premiera		Gjithsej		Ndryshimi tremujor në %
	Tr.2-2018	Tr.2-2019	Tr.2-2018	Tr.2-2019	Tr.2-2018	Tr.2-2019	
Teatri Kombëtar Popullor	32	47	4	2	36	49	36,1
Teatri Kombëtar Eksperimental	115	141	4	2	119	143	20,2
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	24	35	10	12	34	47	38,2
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	61	80	0	2	61	82	34,4
Cirku Kombëtar	40	51	0	0	40	51	27,5
Shfaqje kulturore/premiera gjithsej	272	354	18	18	290	372	28,3


Në tremujorin e dytë 2019, Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka numrin më të lartë të spektatorëve, me 19.154 të tillë, duke shënuar një rritje me 30,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.2 Numri gjithsej i spektatorëve në institucionet kulturore

Numri i spektatorëve	Tr.2-2018	Tr.2-2019	Ndryshimi tremujor në %
Teatri Kombëtar Popullor	8.833	10.585	19,8
Teatri Kombëtar Eksperimental	14.702	19.154	30,3
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor	10.709	18.930	76,8
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	5.614	14.138	151,8
Cirku Kombëtar	9.148	9.163	0,2
Numri i spektatorëve gjithsej	49.006	71.970	46,9

Numri mesatar i spektatorëve për shfaqje ka pësuar një rritje, nga 169 spektatorë për shfaqje, në tremujorin e dytë të vitit 2018, në 193 spektatorë për shfaqje, në tremujorin e dytë 2019. Rritja është në masën 14,5 %.

Fig.1 Pjesëmarja mesatare e spektatorëve për shfaqje në institucionet kulturore



Trashëgimia kulturore

Numri i vizitorëve gjithsej në muze, kala dhe parqe arkeologjike, në tremujorin e dytë 2019 është 331.767 vizitorë, duke shënuar një rritje me 3,0 %, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit të kaluar. Nga totali i vizitorëve në institucionet e trashgimisë kulturore, 103.536 janë vizitorë në muze, 97.446 vizitorë në kala e monumente të tjera dhe 130.785 janë vizitorë në parqe arkeologjike.


Në tremujorin e dytë 2019, numri i vizitorëve gjithsej të huaj në muze, kala dhe parqe arkeologjike ishte 178.560, duke shënuar një rritje me 24,7 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2018.

Gjatë tremujorit të dytë 2019, në të gjithë institucionet e trashëgimisë kulturore vihet re një përqindje më e lartë e vizitorëve të huaj krahasuar me vizitorët vendas.

Tab.3 Vizitorë në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike

Institucionet e trashëgimisë kulturore	Numri i vizitorëve vendas			Numri i vizitorëve të huaj			Numri i vizitorëve gjithsej		
	Tr.2-2018	Tr.2-2019	Ndryshimi tremujor në %	Tr.2-2018	Tr.2-2019	Ndryshimi tremujor në %	Tr.2-2018	Tr.2-2019	Ndryshimi tremujor në %
Muze	59.716	47.066	-21,2	44.666	56.470	26,4	104.382	103.536	-0,8
Kala e Monumente të tjera	49.608	43.264	-12,8	47.900	54.182	13,1	97.508	97.446	-0,1
Parqe Arkeologjike	69.609	62.877	-9,7	50.658	67.908	34,1	120.267	130.785	8,7
Gjithsej	178.933	153.207	-14,4	143.224	178.560	24,7	322.157	331.767	3,0

Fig.2 Përqindja e vizitorëve të huaj në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike



Biblioteka Kombëtare

Në tremujorin e dytë 2019, numri i shërbimeve të njëjësive bibliotekare është 27.180 njësi, 29,3 % më shumë, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2018.

Në tremujorin e dytë 2019, numri i frekuentuesve në Bibliotekën Kombëtare është 37.026, duke shënuar një rritje me 63,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në Bibliotekën Kombëtare, në tremujorin e dytë 2019 janë afishuar 1.118 tituj të rinj dhe 3.699 ekzemplarë të rinj.

Tab.4 Frekuentimi dhe botimet në Bibliotekën Kombëtare

Treguesit	Tr.2-2018	Tr.2-2019	Ndryshimi tremujor në %
Shërbimi i njësive bibliotekare (njësi)	21.029	27.180	29,3
Frekuentimi	22.628	37.026	63,6
Veprimtari Kulturore dhe Shkencore	92	48	-47,8
Numri i hyrjeve të reja:			
Numri i titujve të rinj	627	1.118	78,3
Numri i ekzemplarëve të rinj	2.234	3.699	65,6

Metodologjia

Të dhënat e statistikave të kulturës i referohen vetëm institucioneve qendrore cilat janë në varësi të nga Ministria e Kulturës. Në institucionet qendrore të artit e të kulturës përfshihen: Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave, dhe Çirku Kombëtar.

Në totalin e muzeve, kalave dhe parqeve arkeologjike janë përfshirë institucionet:

MUZE	KALA E MONUMENTE TË TJERË	PARK ARKEOLOGJIK
Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë	Kalaja Berat	Parku Kombëtar, Butrint
Muzeu Arkeologjik, Durrës	Kalaja Gjirokastrë	Parku Arkeologjik, Apoloni
Muzeu i Pavarësisë, Vlorë	Kalaja e Portopalermos	Parku Arkeologjik, Bylis
Muzeu Gjergj Kastrioti, Krujë	Kalaja e Kaninës	Parku Arkeologjik, Shkodër
Muzeu Etnografik, Krujë	Kalaja e Himarës	Parku Arkeologjik, Lezhë
Muzeu Etnografik, Berat	Amfiteatri	Parku Arkeologjik, Amantia
Muzeu Ikonografik Onufri, Berat	Manastiri i 40 Shenjtorëve	Parku Arkeologjik, Orikum
Muzeu i Artit Mesjetar, Korçë	Manastiri i Mesopotamit	Parku Arkeologjik, Finiq
Muzeu Arkeologjik, Korçë		Parku Arkeologjik, Antigone
Muzeu Arsimit, Korçë		
Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi		
Muzeu Kombëtar i përgjimeve " Shtëpia me Gjethe"		

Përkufizime

Trashëgimi kulturore është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara që ruhet në të tashmen, për t’ua përçuar brezave në të ardhmen si pjesë e pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat identitetin, njohuritë, traditat, besimet, si dhe pasuritë kulturore të peizazhit.

Muze është institucioni i ruajtjes së kujtesës, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, që konservon, studion, komunikon dhe prezanton trashëgiminë e luajtshme e të paluajtshme të njerëzimit dhe mjedisit rrethues të tij, me qëllim edukimin, studimin, promovimin dhe argëtimin.

Monument kulture është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti.

Park arkeologjik është territori i përcaktuar me kufij të qartë, që përfshin dëshmi të rëndësishme arkeologjike të mbitokës, nëntokës e nënujit dhe bashkëprani të pasurive historike, peizazhit kulturor, i organizuar me elemente të një muzeu në natyrë.

Pjesëmarrja mesatare e spektatorëve për shfaqje llogaritet duke llogaritur numrin total të spektatorëve në institucionet kulturore me numrin e shfaqjeve të realizuara në këto institucione.

Bibliotekat janë institucione kulturore dhe informuese, që realizojnë hyrje të lirë në informacion në cilëndo formë që ai të jetë depozituar. Ato grumbullojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në dispozicion të përdoruesve koleksionet e veta që përmbajnë informacion në shërbim të formimit të tyre.

Frekuentimi llogaritet me numrin e shërbimeve/materialeve bibliotekare që merr çdo frekuentues i bibliotekës kombëtare.

Materiale bibliotekare përfshijnë libra, artikuj, harta, disertacione, dhe materiale audiovizuale.

Tituj të rinj përfshijnë ato materiale bibliotekare që hyrjë në bibliotekë gjatë një periudhe referuese.

Ekzemplarë të rinj përfshijnë numrin e njësive bibliotekare për çdo titull të ri.